Koment i shkurtër me mendim profesional

Objekt:Kaptazha e shpellës për ujë

Lokacioni:f.Duf – Strugë

Lënda: Turbullimi i ujit të pastër në kaptazhë.

Fillimisht duhet të theksohet se bëhet fjalë për problem të komplkesuar, ku ndikojnë shumë faktorë siç janë:

-ndërtim litologjik i terrenit ku kapen ujërat burimore;

-Ndërtimi i terrenit mbi shpellën, e cila ka përmasa relativisht të mëdha dhe gjatësi nën masën kodrinore (gabariti nuk është i përcaktuar), e ndërtuar nga një seri e re gëlqerorësh masivë, mjaft të çarë në sipërfaqe.

-ndikimet e jashtme atmosferike (borë, shi).

-Tërmetet – bëhet fjalë për afërsinë e një çarje të madhe tektonike (Elbasan – Strugë – Dibër – Kriva Pallankë – Qustendil...). Gjatë tërmeteve më të forta ndodhin ndryshime në lëvizjet e ujërave të akumuluara nëntokësore përmes një numri të madh çarjesh dhe kavernash të mbushura me pluhur, argjilë dhe rërë të imët.

-Faktori njerëzor, prerje më të mëdha të terrenit për rrugë, rrëshqitje, shembje, hapje guroresh dhe huazimesh, si dhe minime të pakontrolluara.

Meqë në momentin kur e përpiloj këtë shkresë nuk disponoj me dokumentacion teknik për disa hulumtime, matje, mund të theksoj se ky mendim është dhënë në bazë të përvojës shumëvjeçare (51 vjet) në hulumtime gjeomekanike, gjeoteknike dhe hidrogeologjike si dhe pjesëmarrje në projekte për sanimin e dukurive të ngjashme në rajonin e Ohrit dhe Strugës.

Herën e fundit kam qenë i pranishëm në vetë kaptazhin para 31 vitesh dhe sot e gjeta të njëjtën gjendje, vetëm me atë ndryshim që rreth kaptazhit dhe liqenit – peshkatores janë ndërtuar mjaft objekte banimi.

Para se të shkoja në shqyrtim në vendin e ngjarjes në zyrë pash dokument nga GIM- Maqedoni, Shkup për një raport në të cilin trajtohet nevoja për hapësirë të mjaftueshëm mbrojtës, për të cilën sigurisht duhet të ketë ndërhyrje të tillë dhe e njëjta të praktikohet dhe të përsoset.

Meqenëse kam qenë i pranishëm kohë të gjatë në këtë rajon dhe i informuar se janë kryer gërmime në disa vende për përdorimin e gurit ndërtimor nga guroret, së bashku me personat e ngarkuar dhe përgjegjës nga Komuna për këtë ndërhyrje, isha të kryej në vendngjarje një vëzhgim makroskopik të gërmimeve të thella me eskavator prej rreth 15–25 m nga sipërfaqja e terrenit të pabarabartë më 16.02.2026. Disa nga ato gërmime në fund tashmë ishin të mbuluara. Këto gërmime janë kryer në drejtim mbi shpellën nëntokësore, në distancë prej rreth 400–600 m (i dhashë detyrë gjeodetit të masë gabaritin e gërmimeve, distancat dhe thellësinë e gërmimeve deri te vetë ndërhyrja – burimi). Gjatë hartëzimit të gërmimeve të thella u regjistruan në vende të veçanta çarje të cilat ishin të mbushura me pluhur argjilor dhe rërë të imët me ngjyrë kafe të kuqërremtë dhe nga e njëjta u bënë fotografi.

Si fakt interesant që mund të theksohet është se masa shkëmbore ka mjaft plasaritje,faktet e gërmimeve të thella ishin të thata, në disa pjesë pak të lagura, edhe pse ditët e mëparshme kishin qenë mjaft me shi me intensitet relativisht të madh në periudha të caktuara.

Nëse fundi i gërmimeve të thella do të ishte i papërshkueshëm nga uji, aty do të kishte një shtyllë uji prej disa metrash me ujë atmosferik të bllokuar dhe të formuara liqene të vogla. Një gjë e tillë nuk kishte që do të thotë se uji nga rreshjet përmes disa plasaritjeve dhe kavernave të mundshme lëviz në thellësi drejt shpellës nëntokësore, prej nga bëhet kapja e ujit nëntokësor.

Nga aty, përmes stacioneve të pompimit, uji kapet dhe dërgohet në rezervuarin në fshatin Zagraçan – Strugë për përdorim të mëtejshëm.

Komenti përfundimtar

Edhe pse mund të shkruhen, interpretohen punë tjera më detale, duke e shfrytëzuar dokumentacionin ekzistues gjeologjik dhe hidrogjeologjik rreth ndërtimit gjeologjik të terrenit dhe vendpozitën e kaptazhit – burimin e shpellës nëntokësore, në disa pika të shkurtar do ti theksoj punët e tjera:

-nuk lejohet që në atë pjesë dhe në zonën më të gjerë të masivit shkëmbor të kryhen gërmime të thella me eskavatorë, hapje guroresh, shpërthime të pakontrolluara ose çrregullime të terrenit, për shkak të vendndodhjes së kaptazhës së ndërtuar dhe gjatësisë, gjerësisë dhe thellësisë së shpellës nëntokësore (dimensionet e së cilës nuk janë përcaktuar plotësisht), e cila përfaqëson kolektor të ujërave nëntokësore me kapacitet që është shfrytëzuar prej shumë vitesh dhe që është karakteristik për masive të tilla gëlqeroreje;

-edhe pse në periudhën para turbullimit të ujit kishte tërmet me forcë deri në 3 ballë MKS, ka më shumë gjasa që turbullimi të jetë pasojë e gërmimit të pakontrolluar të thellë për gurë dhe afërsisë relative të gurores (sipas mendimit tim).

-Në rastin e dhënë paraqiten mjaft pyetje rreth këtij problemi për eksploatimin aktual dhe të mëtejshëm si dhe për mbrojtjen e këtij kaptazhi. Rekomandimi im është që këtë ta bëjë një institucion, dmth. një ekip profesional i përbërë nga disa subspecialistë për këtë lloj dhe i përbërë nga:

- gjeolog

- hidrogjeolog

- hidraulik

- gjeoteknik

- kimist

- speleolog

- zhytës

- gjeodet

- specialist për inçizim me dronë dhe kamera speciale

Ekipi profesional duhet të përfshijë persona kompetentë nga Komuna për këtë problematikë, roje, persona që eventualisht disponojnë me të dhëna për kapacitetin e prurjes së burimit gjatë shfrytëzimit shumëvjeçar (me shkrim ose me gojë), si dhe persona të tjerë që mund të përfshihen për përgatitjen e dokumentit përfundimtar dhe mendim, si dhe projekt për sanimin e nevojshëm.

Si pyetje kryesore për të cilën duhet të jepet përgjigje, është vlerësimi i ushqimit, prurjes dhe drejtimit të mbushjes së pandërprerë për një kohë të gjatë me sasi të mëdha ujërash nëntokësore në kolektorin e shpellës.

Me respekt, Idn Hristo Gjorgjevski

Shkup, 20.02.2026